

MIRDITASI

Më parë se njeriu të vizitojë një vënd, ka ca idhe të cilat munt të jenë në kundrështim me realitetin. Ç' kujton leçitësi kur dëgjon fjalën malësor? Nuk i nënkujton një burrë me dimansione kolosale, trim, kuqerem, e shumë gjëra të tjera të kësaj natyre? Këtë mendim kisha edhe unë mi malësorin Mirditas më parë se të vizitonja vëndin e tij, mirëpo puna s' qëndron kështu.

Ky vjen shtat-mesmë, fytyrë-gjator, mustaqelli (Për zorin, i thonë burrë një njeri si ka musteqe të gjata!), undë-hollë, floke-gëshienjë, sy-gëshienjë (kemi parë një proporsion të math me sy të kalërit), mez-hollë, dhe përgjithërisht i thatë.

Tjatërsoj ëshitë i squar — e rëmben fjalën me një herë — ka fytyrë të qeshur ndonësë rom një jetë të mjerë, i pëiqejnë shakatë, ëshitë i shpejtë në llaf, ka fjalë shumë, ëshitë lodull, ka tolerancë, ndron shpejt pas qarkut, ësl të lanatik, po shpirtin s' e ka fetar, ëshitë lufëtar i mirë, dhe mjaft i shpejtë në këmbët.

Nga vobekësia nuk pashë nonjë Mirditas të ish veshur mirë dhe të kish kosumin vëndës komplet. Aje kam gjetur setra pe t' ushirisë Italiane, Amerikane, Austriake, pe kohën e Pri-